

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE TË KOSOVËS

SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

**I nderuari kryetar i ASHAK, z. Kraja,
Kolege dhe kolegë të nderuar akademikë,
Dashamirëse dhe dashamirë të shkencës dhe librit,
Zonja dhe zotërinj,**

Sot jemi këtu së bashku për të promovuar punën e madhe të kolegut tonë,
Akademik Hivzi Islami, që është finalizuar me librin e titulluar:

DEMOGRAFIA E KOSOVËS

EVOLUCIONI I POPULLSISË, MIGRIMET, GJEOPOLITIKAT EKSPANSIONISTE SERBE DHE SPASTRIMET ETNIKE TË SHQIPTARËVE

Autori i këtij libri, Akad. Hivzi Islami, tanimë i dëshmuar si njohës i proceseve dhe rrjedhave demografike përgjithësisht, e për trevat shqiptare (sidomos për Kosovën në veçanti), brenda një kornize të qëndrueshme metodologjike, ka bërë një punë të madhe në zbardhjen, evidentimin, analizën, interpretimin dhe prezantimin e rrjedhave demografike që lidhen me gjendjen, trendet, ndryshimet, faktorët që i nxisin ato dhe perspektivën e rrjedhës së këtyre proceseve në Kosovë.

Ky libër, edhe pse në shikim të parë, për shkak të kompleksitetit të problematikës që ai shtjellon, por edhe voluminozitetit, krijon përshtypjen e një ndërmarrjeje ambicioze edhe për punë ekipore, mirëpo, falë njohjes së themeltë të fushës, rrjedhave, zotërimit të koncepteve bazike, trendeve dhe konteksteve demografike, sociokulturore, politike, ekonomike etj., autori arriti që me sukses të jashtëzakonshëm të kompletojë këtë studim me shumë vlerë – jo vetëm për aktualitetin shoqëror, demografik, politik, ekonomik dhe sociokulturor të Kosovës, por edhe për shkencën e demografisë në përgjithësi.

Në këtë libër që i kushtohet demografisë së Kosovës, autori me një aparaturë shkencore moderne, qasje profesionale e të bazuar në burimet më relevante të kohës dhe fushës, përthekon komponentet substanciale të rrjedhave demografike të vendit. Migrimet, që si dukuri planetare e godasin edhe Kosovën, madje shumë më herët, natyrshëm lidhen me kontekstin e

klimes politike dhe shoqerore, te cilen autori e ben objekt te analizes, duke ju qasur nga kendveshtrimi dhe dioptria e gjeopolitikes ekspansioniste serbe dhe spastrimeve etnike te shqiptarëve nga keto troje.

Me ketë kornizim ideor të librit, autori realisht sfidohet për një qasje të kompletuar të fenomeneve duke shkuar përtej terrenit demografik të pasqyruar në shifra dhe në tabela. Hyrja e guximshme në analizën e faktorëve politikë, ekonomikë dhe sociokulturorë, analizat dhe interpretimet e rrethanave që krijohen nën trysinë e këtyre faktorëve, ofrojnë një pasqyrim – jo vetëm të kompletuar, por edhe relativisht të ri në fushën e rrjedhave demografike në rajon.

Metodologjia, aparatura shkencore dhe interpretimet e objektive, por shkencërisht të bazuara, pa ndonjë gjurmë të presioneve që burojnë nga realiteti i ngarkuar me veprime të dhunshme të mekanizmave politiko-ushtarak, sistemik dhe të vrazhdë të një pushteti, e bëjnë më të veçantë analizën dhe zbardhjen e fenomeneve që e shoqërojnë rrjedhën demografike të lëvizjeve, ndryshimeve strukturore të familjeve, të vendbanimeve dhe të Kosovës përgjithësisht.

Autori pohon se pas Luftës së II-të Botërore, popullsia bëhet fushë e interesit dhe e kërkimeve shumëdisciplinare, por nëpërmjet indikatorëve demografikë mund të vërehet qartë se si frymon një bashkësi etnike e kombëtare, një sistem socioekonomik, një shoqëri, e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja e saj. Dëshmia më e qartë për këtë është diskursi irracional, neomaltusianist dhe racist i Serbisë dhe i ish-Jugosllavisë në vitet '80-ta të shek. XX e këndej, ndaj natalitetit të shqiptarëve.

Nën pretekstin, kinse të rrezikimit të hapësirës serbo-jugosllave dhe prosperitetit gjeodemografik, politik dhe ekonomik kombëtar të sllavëve të jugut, Serbia dhe ish-Jugosllavia, jo vetëm që haptazi filluan t'i numërojnë shqiptarët dhe ta shndërrojnë shqiptarofobinë në mekanizëm të frikësimit në të gjitha rajonet dhe shtresat shoqërore të popujve jugosllavë, por me të gjitha institucionet u angazhuan për mposhtjen e epërsisë numerike dhe reproduktive të shqiptarëve, për vënien e një baraspeshe etnike nëpërmjet kolonizimit serb dhe dëbimit të shqiptarëve nga hapësirat ku ata jetonin.

Në anën tjetër, faktori demografik po konsiderohej edhe çelës i zgjidhjes së problemeve dhe raporteve politike në shoqëritë multietnike, para së gjithash në hapësirat ballkanike, ku konfliktet ndëretnike ishin të pranishme gjatë gjithë shek. XX. Autori u referohet edhe keqpërdorimeve e shtrembërimeve që në mënyrë sistematike janë shfaqur pikërisht në fushën e demografisë. Një praktikë e këtillë nuk ka munguar as në të kaluarën, mirëpo me politikën e Millosheviqit, që u mbështetë për një kohë të gjatë

edhe nga popujt dhe njësitë tjera të atëhershme federale, Kosovën e mbajtën në shënjestër si vis, që me trendet e natalitetit po shndërrohej në rrezik për krejt Federatën.

Për finalizimin e këtij projekti janë shfrytëzuar të dhënat e regjistrimeve të popullsisë së dy ish-shteteve të shek. XX dhe statistikat vitale zyrtare pas Luftës së II-të Botërore, si dhe të dhënat e regjistrimit të popullsisë së Kosovës të vitit 2011, si shtet i ri, por edhe ato të vitit 2004 së bashku me të dhënat tjera vijuese demografike për sektorët për të cilët ekzistojnë ato me të gjitha kufizimet. Po ashtu, janë shfrytëzuar edhe të dhënat dhe faktet shkencore nga studimet e autorëve të ndryshëm për problemet demografike, sociologjike, ekonomike, historike etj., duke përfshirë këtu edhe rezultatet e hulumtimeve të vetë autorit të këtij libri, të publikuara më parë në organe të ndryshme të kohës, brenda dhe jashtë vendit.

Nga të dhënat që ofrojnë statistikat vitale dhe statistikat vijuese demografike e të tjera, shihet se zhvillimi demografik në indikatorët bazë nuk është i volitshëm. Gjithnjë sipas autorit, këto dhjetë vjetët e fundit nga rënia e normave të lindshmërisë dhe nga emigrimi gjithnjë e më i madh, sidomos i grupmoshave të të rinjve në periudhën e përtëritjes biologjike, shtimi natyror dhe rritja e përgjithshme e popullsisë kanë tendenca të zvogëlimit. Ajo që është e rëndësie të veçantë për trendin e zvogëlimit, sipas autorit del se në periudhën 2010-2021 numri i lindjeve të gjalla është zvogëluar – prej rreth 33.000 në afër 20.000.

Ky libër i takon demografisë materiale, pra demografisë së veçantë ose demografisë së popullatës konkrete, më konkretisht, demografisë së Kosovës, përfshirë këtu edhe aspektet teorike të problemeve përkatëse. Për natyrën e studimeve të këtilla, këtë libër e bën të veçantë begatia e ilustrimeve, të dhënave të mbështetura, skicave, informacioneve dhe projeksioneve, datave dhe burimeve relevante shkencore që nuk lënë asnjë mendim të mbetet pezull. Pra, libri del të jetë aq i kompletuar, sa që e bën – jo vetëm të qartë për studiuesit, por edhe shumë të dobishëm për kompletimin e njohjeve të trendeve që lidhen me historikun e levizjeve të popullsisë, të gjendjes aktuale dhe të perspektivave të tyre në të ardhmen.

Për ta përmbyllur këtë reflektim timin të shkurtër, për librin voluminoz të autorit Islami, lirisht mund të them se para vetes kemi punën e finalizuar nga autori, që shikuar realisht është dashur në vazhdimësi ta kryejnë institucionet përkatëse të Qeverisë së Republikës së Kosovës, meqë, siç pamë, problematikat që shtjellohen në këtë libër janë substanciale për kahjet dhe strategjitë e politikave zhvillimore dhe përgjithësisht shoqërore të

saj. Libri është rezultat i angazhimit individual dhe shquhet me ekspertizë dhe kompetencë të lartë shkencore dhe si i atillë është kontribut i madh jo vetëm për fushën e demografisë, meqë edhe ideja edhe qasja e autorit është multidisiplinare, pasi që ofron përmbajtje, analiza, interpretime dhe përgjigje në shumë çështje që shkojnë përtej kornizës së ngushtë demografike. E përgëzoj autorin Akademik Hivzi Islami për këtë vepër monumentale.

**Prishtinë,
04 shkurt 2021**

Anton Kolë Berishaj